

Të gjitha elementet në një faqe

Microsoft Word nuk shërben vetëm si për të shkruar dokumente por ai është tekst procesor i dokumentave (përpunon dokumentet në forma mjaft atraktive – kjo dukuri njihet me emrin faqosje) në kuptimin e vërtetë të fjalës.

<i>Rubrika1</i>	<i>Rubrika2</i>	<i>Rubrika3</i>
<i>Rubrika1</i>	Rubrika2	Rubrika3
<i>Rubrika1</i>	Rubrika2	Rubrika3
<i>Rubrika1</i>	Rubrika2	Rubrika3

Në mënyrë që dokumenti të ketë pamje sa më atraktive nuk mjafton që ne të theksojmë vetëm:

- Titujt
- Të nënvizojmë ndonjë fjalë
- Të përdorim “Bullets”, apo
- Të përdorim numërimin



Në dokumentin tonë ne gjithashtu mund të përdorim edhe disa elemente të tjera si:

- Tabela
- Fotografi
- **WordArt** (Lloj i veçantë i shkrimit me efekte speciale e cila në përgjithësi përdoret për të krijuar amblema ose logo)

Vërejtje: Ky dokument përbëhet prej dy kolonave (shtyllave) të tekstit. Kjo nuk duhet të ngatërrohet me kolonat në tabela.

Që në dokumentin tonë të fusim një fotografi[&] duhet të ndiqen këto hapa:

1. Klikojmë në dokument ku duam ta vendosim fotografinë.
2. Klikojmë në menynë **Insert**
3. Klikojmë nënmenynë **Picture >**
4. Klikojmë **Clipart** ose **File from** në varësi se a dëshirojmë të fusim ndonjë fotografi nga libraria e Wordit (**Clipart**) apo ndonjë të krijuar në ne.
5. E zgjedhim fotografinë (dokumentin e bërë në Paint në leksionet e kaluara) dhe klikojmë **Insert**.

Kjo kuti quhet text box. Që ta krijojmë një text box duhet të ndjekim hapat e mëposhtëm:

- Klikojmë **Insert>text box**
- Në faqe e zgjedhim zonën ku duam të figurojë text boxi ynë

Formatimi i text boxit bëhet njëlloj si formatimi i elementeve të tjera (fotografi, wordart,...):

1. Aktivizojmë text boxin
2. Klikojmë **Format>text box**
3. Caktojmë layout-et

Që të mbushet me efekte (të ngjyroset ose të ngjyroset me efekte të mermerit apo me nuansa të ngjyrave)ky **TextBox** duhet që:

1. Të zgjidhet
2. Të klikohet **Format> TextBox...**
3. Klikojmë tabin **Colors and Lines**
4. Te rubrika **Fill: Color** e zgjedhim **Fill Effects...** (për efekte ose e zgjedhim ngjyren për ta ngjyrosur me një ngjyrë)
5. Klikojmë tabin **Textures**
6. E zgjedhim llojin e mermerit dhe klikojmë **OK**.

Word Art

[&] Fotografia mund të ndodhet në hard disk ose floppy